



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

Olimpiada e Historisë

Faza II

Viti shkollor 2014 – 2015

Klasa 12 Skema e vlerësimit

15 prill 2015

Pyetja 1. Perandoria romake u nda në dy pjesë në vitin 395. Ndarja e saj u shoqërua me ndryshime edhe në aspektin fetar. Shkruani tre ndryshime në besimin fetar midis Perandorisë Romake të Lindjes dhe Perandorisë Romake të Perëndimit. **6 pikë**

Perandoria Romake e Perëndimit	Perandoria Romake e Lindjes
- Gjuha latine	- Gjuha greke
- Papa kurorëzonte mbretin dhe luante rol kryesor në zgjedhjen e tij	- Peshkopët dhe priftërinjtë zgjidheshin prej perandorëve
- Qendra e kishës ishte në Romë.	- Qendra e kishës ishte në Kostandinopojë
- Besimi katolik	- Besimi ortodoks
- Kalendari ndryshëm fetar	- Kalendari i ndryshëm fetar
- Priftërinjtë nuk martohen	- Priftërinjtë martohen (nuk bëjnë karrierë)

Nxënësi fiton:

6 pikë nëse shkruan 3 ndryshime për secilën prej tyre

4 pikë nëse shkruan 2 ndryshime për secilën prej tyre

2 pikë nëse shkruan 1 ndryshim për secilën prej tyre

Nxënësi nuk fiton pikë nëse shkruan vetëm për njërin nga perandoritë.

Pyetja 2. Baza ideologjike e Revolucionit Borgjez Francez u frymëzua nga idetë e Iluminizmit.

- a) Cilat ishin dy aktet e para të periudhës së Revolucionit ku u materializuan idetë më të rëndësishme të iluministëve (Gusht 1789)? **2 pikë**

Përgjigje:

- Heqja e bujkrobërisë dhe shpallja e fundit të feudalizmit në Francë.
- Miratimi i Deklaratës së të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit.

Nxënësi fiton:

2 pikë nëse shkruan dy aktet e para ku u materializuan idetë iluministe

1 pikë nëse shkruan një nga aktet e para ku u materializuan idetë iluministe

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

- b) Cilat ishin dy nga risitë më të rëndësishme të bazuara në idetë iluministe në kushtetutën e vitit 1791? **2pikë**

Përgjigje:

- Ndarja e pushteteve në ekzekutiv (mbreti), legjislativ (asambleja legjislativ) dhe gjyqësor (të zgjedhur të pavarur).

- Shpallja e formës së regjimit si monarki kushtetuese.
- vendosja e parimit të sovranitetit popullor.
- Te drejtat e njeriut (burrave)

Nxënësi fiton:

2 pikë nëse shkruan dy risitë më të rëndësishme bazuar në idetë iluministe

1 pikë nëse shkruan një nga risitë më të rëndësishme bazuar në idetë iluministe

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

c) Evidentoni dy ndryshimet e sanksionuara në kushtetutën e vitit 1793 krahasuar me atë të vitit 1791? **2 pikë**

Përgjigje:

- E drejta universale e votës për burrat në moshë madhore.
- Ndryshimi i formës së regjimit nga monarki kushtetuese në republikë.

Nxënësi fiton:

2 pikë nëse shkruan dy ndryshimet e kushtetutës

1 pikë nëse shkruan një nga ndryshimet e kushtetutës

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 3. Cili ishte formacioni i parë shtetëror shqiptar i mirëorganizuar gjatë periudhës mesjetare: **1 pikë**

Formacioni shtetëror shqiptar mori tipare të qarta me Principatën e Arbrit.

Nxënësi fiton:

1 pikë nëse shkruan principatën e Arbrit.

Jepni tre argumente për të mbështetur përgjigjen tuaj.

3 pikë

- Principata e arriti kulmin e zhvillimit gjatë qeverisjes së Dhimitrit. Titujt që mori Dhimitri e forconin karakterin shtetëror të principatës
- Ai e forcoi figurën e shtetit edhe nëpërmjet aftësive diplomatike. Për të shmangur rrezikun serb nga veriu ai u martua me vajzën e mbretit Stefan. Etj
- Vendosja e marrëdhënieve me Republikën e Raguzës, Perandorinë Bizantine, Papatin etj
- Territori i principatës zinte një të tretën e trojeve të banuara nga shqiptarët
- Principata kishte stemën me shqiponjë më një kokë. etj

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse shkruan një nga argumentet e mësipërme

2 pikë nëse shkruan 2 nga argumentet e mësipërme

1 pikë nëse shkruan një nga argumentet e mësipërme

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 4. Në qytetin e Lezhës u thirr një Kuvend më 2 mars 1444 ku morën pjesë përfaqësues të elitës politike të kohës.

a) Jepni tre argumente pse u zgjodh Lezha si vend i mbajtjes së Kuvendit

3 pikë

Nuk ishte nën zotërimin e asnjërit prej fisnikëve shqiptar

Nuk ishte nën sundimin e Perandorisë Osmane

Ishte nën zotërimin e Venedikut, të cilin shqiptarët e konsideronin si aleat të besueshëm

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse jep tre argumentet e mësipërme

2 pikë nëse jep dy nga argumentet e mësipërme

1 pikë nëse jep një nga argumentet e mësipërme

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

b) Shpjegoni dy nga vendimet e Kuvendit të Lezhës

4 pikë

Krijimi i një aleance politiko-ushtarake të princave shqiptar që do të funksiononte si një “Besëlidhje Shqiptare” që njihet si “Lidhja e Lezhës”

Organi më i lartë vendimmarrës do të ishte Kuvendi i Lezhës me kryetar Skënderbeun (i pari midis të barabartëve)

Krijimi i një ushtrie që përbëhej nga reparte të përhershme dhe të përkohshme, komandant Skënderbeu

Krijimi i një arke të përbashkët ku secili nga fisnikët shqiptar do të derdhte kontributet e tij.

Nxënësi fiton:

4 pikë nëse shpjegon dy nga vendimet e kuvendit të Lezhës.

3 pikë nëse shpjegon njërin nga vendimet dhe thjesht përmend njërin prej tyre

2 pikë nëse shpjegon një nga vendimet OSE përmend dy prej tyre

1 pikë nëse thjesht përmend njërin nga vendin

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 5. Më 21 janar 1925 Asambleja Kushtetuese shpalli Republikën Shqiptare dhe në mars të po atij viti u miratua Statuti Themeltar i Republikës ku Shqipëria përcaktohej si republikë parlamentare.

a) Republika shqiptare edhe pse de jure ishte parlamentare, de facto kishte karakterin e një Republike Presidenciale. Presidenti kontrollonte të gjitha pushtetet. Shpjegoni si e realizonte ai këtë kontroll.

3 pikë

- Ai kontrollonte të gjitha pushtetet:
- Ekzekutivin pasi emëronte dhe shkarkonte ministrat.
- Legjislativin pasi përdorte të drejtën e vetos për ligjet, shpërndante parlamentin dhe caktonte zgjedhjet e reja.
- Gjyqësorin pasi emëronte gjyqtarët dhe prokurorët.

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse shpjegon kontrollin në të tria hallkat

2 pikë nëse shpjegon kontrollin në dy prej hallkave

1 pikë nëse shpjegon kontrollin në njërin prej hallkave

0 pikë nëse thjesht identifikon hallkat OSE nëse përgjigjet gabim OSE nëse nuk përgjigjet fare

Pyetja 6. Gjatë periudhës së Republikës, aleati kryesor i Shqipërisë ishte Italia me të cilën gjatë periudhës së Republikës (1925-1928), u nënshkruan dy paktet e Tiranës

a) Shpjegoni përmbajtjen e tyre

4 pikë

Pakti i Tiranës u nënshkrua më 27 nëntor 1926 , u quajt “Pakti i Miqësisë dhe Bashkëpunimit”. Afati ishte 5 vjeçar dhe Italisë i njihej e drejta të ndërhynte në Shqipëri kur ajo rrezikohej të pushtohej ose kur kërcënohej nga lëvizje të brendshme.

Pakti II i Tiranës u nënshkrua më 22 nëntor 1927, u quajt “Pakti i Aleancës Mbrojtëse të Pandryshueshme”. Afati ishte 20 vjeçar. Të dy shtetet zotoheshin të ndihmonin njëri-tjetrin në rast të një sulmi ushtarak nga një vend i tretë. Italia vendoste kontrollin mbi ushtrinë shqiptare si edhe një këshilltar italian pranë Zogut.

Nxënësi fiton:

4 pikë nëse shpjegon të dy Paktet e Tiranës

3 pikë nëse shpjegon saktë njërin nga paktet dhe pjesërisht tjetrin

2 pikë nëse shpjegon njërin nga Paktet e Tiranës OSE shpjegon pjesërisht të dy Paktet

1 pikë nëse shpjegon pjesërisht njërin nga paktet

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

b) A ishte qeveria shqiptare në pozita të barabarta me Italinë me këto pakte? Argumentoni përgjigjen tuaj.

2 pikë

Qeveria shqiptare me këto pakte nuk ishte në pozita të barabarta, pasi Italia vendoste jo vetëm kontrollin politik por edhe atë ushtarak. Në këtë rast cenohej sovraniteti i shtetit shqiptar.

Nxënësi fiton:

2 pikë nëse bën argumentim të plotë

1 pikë nëse bën argumentim të pjesshëm

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare

Pyetja 7. Në gusht 1943 në takimin e mbajtur në Mukje morën pjesë përfaqësues të FNC dhe të Ballit Kombëtar.

a) Evidentoni tre nga vendimet e marra me miratimin e përfaqësuesve të dy palëve në këtë takim **3 pikë**

- Krijimi i një Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë ku të dy palët do të përfaqësoheshin në mënyrë të barabartë.
- Luftë të përbashkët kundër pushtuesit përkrah aleatëve të Kombeve të Bashkuara, zbatimin e Kartës së Atlantikut për vetëvendosjen e popujve, për një Shqipëri etnike, të lirë, demokratike e popullore.
- Forma e regjimit do të vendosej pas Luftës me zgjedhje të lira e demokratike.

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse evidenton tre nga vendimet

2 pikë nëse evidenton dy nga vendimet

1 pikë nëse evidenton një nga vendimet

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare

b) Shpjegoni arsyet pse PKSHE i hodhi poshtë pikat e kësaj marrëveshjeje **3 pikë**

PKSH nuk i pranoi pikat e marrëveshjes me justifikimin se:

- nuk pranonte të ndante fitoret e deritanishme të luftës,
- nuk pranonte të ndante edhe pushtetin me forcat e tjera
- vendimi për Shqipërinë etnike binte ndesh me interesat e komunistëve jugosllavë

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse shkruan tre nga arsyet

2 pikë nëse shkruan dy nga arsyet

1 pikë nëse shkruan një nga arsyet

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare

Pyetja 8. Në përfundim të Luftës II Botërore u krijua qeveria e re shqiptare.

- a) Identifikoni dy nga shtetet që nuk e njohën qeverinë shqiptare fill pas luftës. **2 pikë**

Përgjigje:

SHBA, Angli etj.

Nxënësi fiton:

2 pikë nëse shkruan dy nga shtetet që nuk e njohën qeverinë shqiptare

1 pikë nëse shkruan një nga shtetet që nuk e njohën qeverinë shqiptare

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

- b) Identifikoni një nga shtetet që e njohën qeverinë shqiptare fill pas luftës. **1 pikë**

Përgjigje:

Bashkimi Sovjetik dhe vendet e bllokut komunist si edhe Franca

Nxënësi fiton:

1 pikë nëse shkruan një nga shtetet që e njohën qeverinë shqiptare

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

- c) Përse u acaruan marrëdhëniet midis SHBA, Anglisë me qeverinë shqiptare pas zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945? **1 pikë**

Përgjigja:

Për shkak të mungesës së demokracisë gjatë zgjedhjeve dhe moslejimit të misionëve anglo - amerikanë gjatë zgjedhjeve të dhjetorit 1945. (Marrëdhëniet u përkeqësuan më shumë edhe për shkak të incidentit në Kanalin e Korfuzit).

Nxënësi fiton:

1 pikë nëse shkruan një nga arsyet e mësipërme

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 9. Shkruani një ese të mirë organizuar, e cila përfshin hyrjen, disa paragrafë që mbështesin tezat tuaja dhe një përfundim. **8 pikë**

Tema e esesë: E ardhmja e botës shqiptare në Ballkan, drejt Bashkimit Evropian.

Ëndrra më e madhe e shqiptarëve ka qenë dhe mbetet Evropa. Integrimi në familjen evropiane, për Shqipërinë ka qenë një synim parësor prej ndryshimeve demokratike në fillim të viteve '90 të shek. XX e deri në ditët tona. Në vijillje të shek. XXI, shqiptarët në Ballkan përfaqësohen me dy shtete, ndërsa në Maqedoni, Mal të Zi, e Serbi, gjithashtu proceset integruese janë një sfidë e rëndësishme.

- Identifikoni shtrirjen e shqiptarëve në Ballkan.
- Përshkruani sfidat e shqiptarëve në procesin e integritimit në familjen evropiane.
- Analizoni: Bashkimi Evropian një ëndërr apo detyrim për botën shqiptare.

Kriteret e vlerësimit të esesë historike

Kriteri I: Organizimi dhe struktura e esesë

2 pikë

Struktura e esesë respekton këto elementë:

- hyrjen; - zhvillimin; - përfundimin. Nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës. – **1 pikë**
- Organizimi i esesë - ka një organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri). - **1 pikë**

Kriteri II: Analiza

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi: shkruan një ese, ku argumenton idetë e tij për temën e dhënë;

- mban qartë një pozicion të dukshëm në argumentet e dhëna; ka qartësi mendimi. - **1 pikë**
- përdor shembuj dhe mbështetet në argumente bindëse për përgjigjen e dhënë - **1 pikë**

Kriteri III: Stili dhe origjinaliteti

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi: përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të qartë për atë që do të shprehë;

- shprehet me një gjuhë të saktë dhe pa huazime (nuk mund të shprehte me terma të tilla si: kontestim, konfliktualitet etj., stil origjinal. - **1 pikë**
- përdorë saktë dhe në vendin e duhur termat historik; - **1 pikë**

Kriteri IV: Aspekti kronologjik

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- Ndjek në mënyrë kronologjike ngjarjet që lidhen me tematikën e esesë; Strukturon esenë në mënyrë të tillë, për të qenë besnik i aspektit kronologjik. – **1 pikë**
- Përpiqet të përshtatë idetë e tij me kronologjinë e ngjarjeve, duke shmangur një kronikë të thjeshtë historike, por duke e përdorur kronologjinë në funksion të argumenteve të esesë - **1 pikë**